



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-11379/21
Kaçanik, 29.04.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV-të (Katërt)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 29.04.2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarët- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Ukshin Qallaku dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Ilirjana Berisha, Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Fatlume Guri-Selimi.

Në mbledhje morën pjesë 6 persona- përfaqësues të grupit të interesit lidhur me pikën 6 (investitorët dhe pronari Agroni Zeneli, me bashkëpunëtorët e tij francezë).

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatojmë pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kuorumi ekziston, prezentë në mbledhje janë 27 anëtarët- të gjithë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IV-të (Katërt) të Rregullt për vitin 2021, data 29.04.2021, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021;
3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;
4. Propozim Vendimi për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të Komunës së Kaçanikut dhe NPK "Stacioni i Autobusëve" Kaçanik;

5. Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m², në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës "Ismail Raka" – segmenti nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri të "Xhamia e Dëshmorëve" në Kaçanik;
6. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, Parcelën kadastrale Nr. 01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, P.SH – Kullosë e klasës së 3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negocimit të ofertës;
7. Propozim Vendimi për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;
8. Rishqyrtimi i Vendimit të KK 01Nr. 60/01-11084 i datës 18.03.2021 sipas kërkesës së MAPL, për harmonizimin e aktit me legjislacionin në fuqi;
9. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2020;
10. Raporti i punës i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2020; dhe
11. Aprovimi i dorëheqjes së anëtares së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, Albana Fuga.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së III-të (Tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 18.03.2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-7731/21.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Selim Reka, Faleminderit, përshëndetje për të gjithë; Unë e kam një Pyetje dhe një Kërkesë për rrugën e cila u shtrua tani. Trotuari i rrugës "Ismail Raka", nuk e di a është bërë pranimi teknik ende apo jo, sepse ka shumë mangësi të cilat kanë ngelur aty dhe kjo bien keq për syrin e qytetarëve. Disa pllaka janë thyer dhe ato duhet të zëvendësohen. Kërkesa është; Pasi që janë hequr ulëset në bulevard, kërkoj të ngritët muri dhe të bëhet ulëse ajo pjesë për gjatë bulevardit dhe të vendosen edhe shportat e mbeturinave. Kush ka qenë në, Bajram Curr e ka parë sa bukur është bërë një formë e tillë e ulëseve.

znj. Hafize Sallahi, Përshëndetje për të gjithë; Unë kam një kërkesë nga banorët e f. Biçec, me konkretisht të disa lagjeve, për emërtimin e rrugëve, sepse ka kohë e gjatë që nuk janë bërë emërtimet e rrugëve, dhe qytetarët po kanë probleme për shkak të adresave, pasi që në lagjet e tyre rrugët janë pa emër. Administratori i f. iu ka thënë se e ka bërë kërkesën më herët, mirëpo nuk janë marrë masa, kështu që banorët e fshatit kanë kërkuar që në një afat sa më të shkurtër të bëhet emërtimi i rrugëve të cilat kanë mbetur pa emërtuar. të f. Biçec.

z. Adnan Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Kryetar desha t'iu pyes edhe një herë dhe t'iu përkujtoj se në qershor të vitit 2018, Kuvendi i Komunës nga Zyra e Kryetarit ka ndarë 3,000.00€ për zhvarrosjen dhe transferimin e eshtrave të luftëtarëve të çështjes kombëtare, Avdyll Dura dhe Ramë Beka. Nga ajo kohë nuk është bërë asgjë. A mund t'na tregoni ku ka ngelë kjo çështje dhe ku janë ato para.

znj. Vlora Dalloshi, Përshëndetje për të gjithë; E kam një pyetje për drejtoreshën e Shëndetësisë; Dihet se procesi i vaksinimit ka filluar në tërë territorin e Kosovës dhe dihet së na jemi një vend malor, ku ka persona të moshuar të cilët kanë mundësi mos me pasur qasje direkt në vaksinim. Desha me pyetur; Sa është e angazhuar drejtoresha e shëndetësisë me iu krijuar mundësinë që personat të cilët nuk mundën me ardhur në ambulancë me kryer vaksinimin, me iu ofruar shërbimi i vaksinimit në shtëpi?

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit; Unë gjatë shqyrtimit të raportit financiar të vitit 2020, e kam potencuar së ka munguar tabelari për shpërndarjen e subvencioneve në mënyrë analitike. Kërkoj edhe një herë nga drejtori i DFEZH t'na i sjellë tabelarin për shpërndarje të subvencioneve të vitit 2020.

z. Agim Mani, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Unë para 4 muajve e pata bërë një pyetje në DSHPE për objektin kolektiv banesor, në rrugën "Idriz Seferi". Suvatimi i atij objekti është bërë vetëm në pjesën ballore. Pyetja ime ka qenë; A është lënë në harresë pjesa tjetër, apo çka është në pyetje, a mos bëhet suvatimi i pjesëve tjera në fazën e dytë? Lidhur me këtë pyetje, nuk kam marrë përgjigje deri me tani. Nëse është neglizhuar pyetja, unë e bëjë përsëri të njëjtën pyetje?

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Desha një pyetje; Të Bulevardi i qytetit, kubëzat e vjetra të trotuarit janë hequr dhe zëvendësuar me kubëza të reja., Desha me ditur; Ku kanë mbetur kubëzat e vjetra? A janë dërguar në destinacionin e përcaktuar për parkingun e veteranëve?

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje dhe Kërkesa të tjera nuk ka, besoj së përgjigjet do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës në mbledhjen vijuese të KK. Vazhdojmë me rendin e punës;

2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021;

Besoj së materialin e keni marrë dhe e keni lexuar, para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i financave, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi-drejtor i DEFZH, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Si çdo vit, edhe këtë vit e kemi dërguar Propozim Vendimin për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2020 në vitin 2021. Është proces i rregullt, por kërkon miratimin e KK. Buxheti i Komunës së Kaçanikut për këtë vit është diku, 8.7 milion, ndërkaq me bartjen e shumës së

mjeteve 506,352.72 (pesëqind e gjatë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë dy cent) buxheti i komunës arrin afër 9.3 milion euro. Mjetet janë shpërndarë në këtë mënyrë; Për Mallra dhe Shërbime, 20,000€, Subvencione dhe Transfere, 32,705.40€, Investime Kapitale, 453,647.32€. Tani do t'ua paraqes tabelën e investimeve kapitale: të projekti me Nr. 1 Furnizim me mobilje dhe pajime, është të administrata komunale. Me buxhet të sivjetmë janë 5.000€ të ndara, mirëpo për shkak të vendosjes së pajisjes “I- Ciosku” për marrjen e certifikatave on-line edhe jashtë objektit të komunës, nga paramasa, shihet së duhet të shtohen edhe 10.000 € nga të hyrat e bartura, 15.000 € kushton realizimi i këtij projekti. Pastaj kemi të, Ndërtimi dhe funksionalizimin i objektit të banimit social, 50.000€, duhet të jenë me buxhetin aktual, ndërkaq nevojiten edhe 150.000€ me u bërë funksional ai objekt, për me iu bërë zgjidhje afër 25 familjeve me nevojë. Hartimi i projekteve, me buxhet janë 30.000 €, duhet shtuar edhe 10.000 €, për shkak së më nuk lejohet menaxherëve të projekteve të hartojnë projekte, sepse ata janë të thirrur t'i mbikëqyrin projektet, ndërkaq hartimi i projekteve duhet bëhet nga operatorët e ndryshëm të jashtëm. Renovimin i objekteve banesore kolektive, i kemi 20.000 € duhet të shtohen edhe 50.000 € me bartje, për shkak së ka plane drejtoria e Urbanizmit për rritjen e standardit të qytetarëve në pjesën urbane të qytetit. Ndërtimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave, janë 50.000 €, ndërkaq duhet shtohet shuma edhe 18.000 € me bartje për shkak së paramasat flasin që projekti do të kushtoj deri në 70.000 €. Mjetet për bashkëfinancim të projekteve janë, 100.000€, qysh tani i kemi disa marrëveshje që e kanë kaluar këtë kosto dhe duhet patjetër të shtohen mjete. 70.000€, është rruga që lidhët me pjesën urbane dhe magjistralen dhe bulevardin e qytetit, pastaj është ndriçimi publik 100.000 €, por nuk mjaftojnë për realizimin e krejt projektit. Kanalizimet fekale dhe atmosferike 15.000€, renovimi i objektit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” duhet shtohen edhe 10.000 €, me arritur shumën 25.000 € me u kryer projekti. Renovimi i objekteve dhe infrastrukturës shkollore, 100.000 € janë me buxhet, edhe 72.000 € do të shtohen në realizimin e këtij projekti. Këtu kemi pasur parasysh edhe kërkesat nga KPF nga anëtarë Selim Reka, për renovimin e shkollëve të gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik. DAK e ka aprovuar këtë kërkesë dhe besoj së do të inkorporohet kjo shumë. Kostoja e shkollëve është diku 50.000 € dhe nuk ka arsye të mos përkrahet ky projekt. Asfaltimi i rrugës “Ramadan Xhokli” në Koxhaj, 50.000 € janë me buxhet, duhet shtohen edhe 35.000 €, për shkak së paramasat janë ashtu për realizimin në tërësi të këtij projekti. Ky proces është i rregullt i bartjes së mjeteve, këto mjete duhet shpenzohen sivjet, dhe krejt këto mjete shkojnë në ngritje të mirëqenës së qytetarëve. Faleminderit për durimin tuaj dhe kërkoj mbështetjen e këtij Propozim Vendimi për bartje të mjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Faleminderit drejtor, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Unë po e potencoj se, shuma që bartet nga viti në vit, në krahasim më vitin e kaluar është shtuar për 100.000 €. Shuma 506,352.72 € që bartet, është një shumë e madhe e mjeteve, duke pasur parasysh buxhetin e vogël që ka komuna dhe për kundër nevojave që ka komuna, nuk po jemi në gjendje të shpenzojmë krejt buxhetin. Të shpërndarja e mjeteve të ngelura, e kam vërejtje të ndarja e mjeteve për banim social. Deri tani besoj se ka arritur shuma e ndarë gjysmë milioni euro nga komuna për atë ndërtesë. Besoj se kjo shumë është tepër e madhe dhe i ka tejkaluar krejt mundësitë.

z. Bekim Koxha, Desha të ndërlidhem të diskutimi i z. Ekrem Kyçyku të çështja e ndarjes së mjeteve për banesën sociale. Unë nuk e di çka është në pyetje me atë banesë ? Unë nuk e di sa herë janë ndarë mjete për atë banesë ? A mundet me na treguar drejtori; Përse nuk u krye ai objekt edhe me mjetet e qeverisë që janë ndarë ? Pse mbeti në gjysmë ai projekt ? Pse u pranua ai objekt në gjysmë? Një herë i ndamë 60.000 €, një herë tjetër i ndamë mbi 70.000 € dhe përsëri tani po i ndajmë, 110.000€ për atë objekt. Unë nuk e di, sa herë duhet me ndarë mjete

komuna për atë banesë sociale. Unë nuk e di së ku është problemi i atij objekti të banimit social.

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Edhe në KPF i kemi paraqitur shqetësimet tona lidhur me këtë pikë. Shqetësimet tona kryesisht kishin të bënin me mbetjet e mjeteve të DAK dhe të DBPZHR etj. kur dihen nevojat në arsim dhe në bujqësi janë të mëdha, ndërkaq nuk janë shpenzuar mjetet buxhetore të planifikuara. Një kërkesë e ime e ngritur në KPF është përkrahur, ndërkaq unë pata edhe kërkesën për pajisjen e shkollave me projektor statik. Shuma nuk është e madhe, ndërkaq realizimi i këtij projekti kishte me bërë mësimin më atraktiv. Të investimet kapitale, mund të kemi ndonjë vërejtje aty këtu, sidoqoftë ne jemi të mbështetët bartja e mjeteve të projektuara.

z. Bahri Selimi, Të shqetësimi i z. Ekrem Kyçyku, që tha së është shuma e lartë e mjeteve që po bartet, 506 mijë euro. Viti 2020 të gjithë e dimë sa është karakterizuar me vit pandemie dhe kërkesat që ka paraqitur të cilat më së tepërmi kanë të bëjnë me çështjet financiare. Çdo kërkesë apo nevojë e qytetarëve ka rezultuar me anën financiare. Me rastin e pandemisë edhe procedurat e tenderimit për projekte kanë qenë të bllokuara deri në qershor. Nga qershori deri në fund të vitit kemi filluar me proceduar dhe kemi arritur me shpenzuar GQ. Të HVK janë kursyer, për shkak së ligji e lejon që të njëjtat me u bartur në vitin vijues. Unë i kam edhe tabelat se ku kanë mbetur projektet dhe pse kanë mbetur. Në të ardhmen në mend t'i paraqesim kontratat e arritura dhe shumat e shpenzuara për "X" projektin e shpenzuar. Është kriter të shpenzohet fillimisht fondi 10 i GQ, kalohet të fondi 21 dhe pjesa që ngelet, bartet. Bartja e mjeteve të pashpenzuara është bukur e madhe, por për shkak të ngecjeve që i potencova, kjo shumë ka ngelur pa shpenzuar.

z. Bekim Koxha, Ne edhe paraprakisht ua kemi tërhequr vërejtjen se kanë më mbetur mjete të pashpenzuara. Për këtë iu kemi thënë të keni kujdes që t'i shpenzoni mjetet në afat dhe mos të mbesin, sepse kjo po na përsëritet çdo herë, ashtu që po na mbesin mjete nga 400-500 mijë euro në vit të pashpenzuara.

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo sigurisht bëhet për shkak të alokimeve të brendshme në muajin e dhjetorit që nuk mundesh me alokuar mjete më. Këtë e kemi sqaruar shumë herë. Është mirë që mjetet mos me humbur, pse barten në vitin vijues nuk është gjë e keqe. Është mirë që GQ të shpenzohet në maksimum. Besoj se çështja e bartjes së mjeteve të pashpenzuara është në rregull.

z. Bekim Koxha, A bënë më na dhënë sqarime drejtori për çështjen e mjeteve që barten për banesën sociale, ku qëndron problemi ?

Kryesuesi i Kuvendit, Për çështjen bartjes së mjeteve për banesën sociale, fjalën e kërkoj kryetari, besoj së kryetari ka me tepër njohuri, atëherë për sqarime të nevojshme fjalën e ka Kryetari i Komunës - Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Sa i përket mjetet të cilat i ka ndarë komuna për objektin e banimit social, ato mjete janë shpenzuar. Mjetet e qeverisë nuk janë shpenzuar dhe në mungesë të mjeteve të qeverisë që vazhdimisht në një farë forme kemi pasur një lloje pengese në ekzekutim, ne jemi detyruar që këtë pjesën tjetër prej 110.000 € me destinuar për këtë objekt. Nuk janë shpenzuar për atë objekt mjete buxhetore të komunës 500.000€, por diku arrin vlera 400.000€ dhe mundesh Ekrem me ardhur me i marrë shifrat sakët. Mjetet tona Bekim i kemi shpenzuar, dhe në mungesë të mjeteve me përmbyllur

këtë projekt që ka mbetur si kullë atje, jemi detyruar me kërkuar miratimin e KK, për shkak se edhe ne jemi bërë horë në këtë drejtim, por ja që nganjëherë kemi pasur pengesa nga niveli qendror, për shkak të procedurave që zakonisht janë arsyetuar dhe e kemi pa të arsyeshme këtë vit me pa ndryshime. në këtë vit niveli qendror nuk kanë paraparë mjete buxhetore për këtë kategori objekti. Ne si komunë e kemi pa të arsyeshme që mjetet tona vetanake me i shpenzuar dhe me përmbyllur këtë projekt.

z. Ekrem Kyçyku, Kontrata e parë është nënshkruar ka qenë; 343.974 €.

Kryetari i Komunës –Besim Ilazi, Shumë në rregull Ekrem, nuk e kontestova kontratën, por sa mjete janë shpenzuar të asaj kontrate, ky është problemi im. Nëse keni shifra sa janë shpenzuar, atëherë del së nuk është ashtu si e thatë ju. Nuk thash që nuk është kontrata në rregull dhe që nuk kemi dhënë ne mjete nga KK, por mjetet nuk janë shpenzuar për shkak të procedurave të nivelit qendror. Nëse keni shifra sesa janë shpenzuar, atëherë del së nuk është ashtu si thoni ju.

z. Adnan Reka, Edhe unë do të ndërlidhem me këtë pikë; në vitin 2017, 343.974 € siç tha edhe Ekremi janë ndarë, bile janë dhënë 44.000€ më tepër, sesa vlera e parashikuar e kontratës. Në vitin 2019 janë ndarë 78.515 €. Afati me u përfunduar ka qenë 30 ditë, kjo nuk ka ndodhë. Aneks kontratën e negociuar pa procedurë ka qenë, 34.397€. Gjithsej këto bëjnë 456,887 € Nëse i mbledhim këtë shumë, plus shuma 110.000 € për të cilat po flasim, tejkalojnë shumë e gjysmë milioni euro. Me këtë gjysmë milion euro, ne po ndërtojmë 24 banesa për banim social me nga 60-70m2, dhe po të pjesëtojmë këto me 36 mijë euro del një banesë. Unë nuk e di a po ndërtojmë banesa për social a po shesim banesa. Nga viti 2017 e deri në vitin 2021 këto punë nuk kanë përfunduar. Kontrata i jepet një kompanie, punët i kryen një kompani tjetër, gjë që në kontratë shkruan që nuk mundet me iu bartë punimet kompanisë tjetër. Ne po e shohim që kontratën e ka marrë tjetër kush, ndërkaq punët i kryen dikush tjetër. Këto krejt janë parregullsi të cilat kanë ndodhë.

Kryetari i Komunës –Besim Ilazi, Adnan mos u bënë merak për këtë punë, lënda është në krime ekonomike. E dya, në vitin 2018 dhe 2019 nga 200.000 € që janë ndarë për këtë projekt dhe me i mbledhur krejt bëjnë 1 milion euro. Nuk e kontestova shumën, as kontratën e as nuk po e kontestoj që në vitin 2018 dhe 2019 e njëjta ministri ka ndarë nga 200 mijë euro, por e thashë së mjetet nuk janë shpenzuar. Sa i përket kompanive të cilat punojnë, janë dy kompani të cilat janë përzgjedhur me punuar aty. Lënda është në krime ekonomike, kështu që mos u bënë merak se çdo gjë ka me u sqaruar.

z. Adnan Reka, Faleminderit kryetar për informata, por nuk po flasim për paratë e ministrisë, por po flasim për paratë e komunës, kontratat e komunës. Nëse ato mjete nuk janë shpenzuar qysh po thoni ju kryetar, qysh keni mundur me dhënë mjete tjera, qysh keni mundur me ndarë mjete tjera, ju në vazhdimësi keni ndarë mjete. Unë jam duke i përmendur me vite, 2017, 2019, 2021, ndani mjete tjera ende pa i shpenzuar ato të parat. Mirë që na sqarova që lënda është në krime ekonomike, e kemi në konsideratë këtë informatë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin për bartje të mjeteve e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarë (7 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021 / Lënda: 01Nr. 400/01-10977/21.

3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me hapë diskutimin, për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Faleminderit kryesues, Propozim Vendimi përbëhet nga dy pika: Pika 1 ka të bëjë me transferin e mjeteve nga rezerva e komunës. Buxheti i vitit 2021 është miratuar nga KK, por kanë dalë disa procedura të reja nga MEF, dhe ka lindë nevoja të rishqyrtohen edhe 1 herë nga KK. dy projekte përfshirë si në pikën 1.1 dhe 1.2 ku nga e njëjta drejtori bëhet transfer nga rezerva në investime kapitale ashtu siç është miratuar buxheti, mirëpo kanë mbetur në rezervë për shkak të disa kriterëve të vogla

Pika 2 e vendimit ka të bëjë me; Meqë jemi në kushte pandemie, sektori i arsimit është dëmtuar bukur shumë. Përmes këtij propozim vendimi kërkojmë nga ju që shumën afër 12.000€, të bartin në mallra dhe shërbime, ku kemi nxjerrë mjete nga secila drejtori komunale nga 15% sa na lejon ligji i ndarjes buxhetore, si p.sh. të Urbanizimi 40.000€ nga mallrat dhe shërbimet lejohet të bartën 15% në ndonjë nën program buxhetor aty ku ka nevojë, pastaj të Bujqësia, Pylltaria, Shërbimet Kulturore etj. kjo për arsye së në vitin e kaluar me vendim të qeverisë 01/27 të datës 06 shkurt 2021, bazuar në master planin e MASH për vitin 2021. Për vitin 2021 është marrë një vendim, ku është ndarë shuma 69.695 €, për të gjitha shkollat e nivelit fillor të komunës. Për vitin 2020 janë ndarë 57.000 €, këto janë realizuar dhe janë shfrytëzuar nga DAK për krejt nevojat që janë paraparë në pandemi, si; zëvendësimi i arsimtarëve, dezinfektimi i objekteve arsimor, pajisja me mjete higjienike. Tani kemi marrë konfirmim që shuma 69.695 euro nuk alokohet për asnjë komunë e as për komunën tonë. Jemi në pozitë të pavoritshme të arsimit fillor, kjo është vetëm kërkesa e parë, pasi që, nëse qeveria vazhdon të mos alokojë mjete për arsim nga programi i rimëkëmbjes dhe pakos fiskale, përsëri kemi me ardhur këtu në KK së nuk mjaftojnë shuma 12.000€, sepse ky sektor është më i atakuari me numër të madh të nxënësve dhe stafit arsimor, ku pasojat i bartë nxënësi dhe prindërit. Kërkoj mirëkuptim ta mbështesim sektorin e arsimit me shumën 11.992 €, vetëm sa për t'i kaluar disa nevoja më të shpejta.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Unë e kam një problem tjetër, problemi është, po të shikojmë planifikimin e këtij buxheti, gati çdo 2-3 muaj kemi transfer apo rialokim të mjeteve. Kjo me duket pak e tepër në çdo 2-3 muaj me pasur rialokim apo transfer të mjeteve. Kur t'i shikojmë ato mjete së ku shkojnë, në rastin e arsimit në rregull, por në rastin e banesave sociale, me rialokuar në vazhdimësi mjete për t'i transferuar në vende të caktuar, kjo është e papranueshme.

z. Besim Vishi, Kërkoj një sqarim të shuma 50.000€, A shkon kjo shumë të banesa sociale. sepse paraprakisht ishte shuma 110.000€ e destinuar me u bartë për të banesa sociale.

z. Bahri Selimi, Po, ka të bëjë me të njëjtin projekt, por këtu ky projekt është miratuar shuma 50.000€ për sivjet. Edhe projekti kapital, Ndërtimi dhe Rregullimi i Qarshisë së Vjetër të Qytetit, i cili e ka pasur koston 200.000€, dhe ky 50.000 €, është një Udhëzim administrativ i cili i parasheh disa kriterë që nuk janë plotësuar sa duhet. Sipas analistave të buxhetit edhe një herë kanë me hyrë në PIP. Edhe një herë kemi me i dhënë shënimet sa përfitues përfitojnë,

kostoja sa është projekti, për të dy këto projekte, mirëpo sipas ligjit dhe UA, vendimi përsëri merret në KK. Buxheti i miratuar nuk shtohet të asnjëri projekt. Nëse këto mjete bartët shuma 110.000€ plus shuma e paraparë 50.000€, bëhen 160.000€ për këtë projekt. Të kriteret, minimumi i projektit është me i pasur 100 pikë, nga zyrtarët tonë kur është deklaruar i ka pasur 269 pikë nga 300, mirëpo sipas analistave të financave është vlerësuar që edhe 1 herë të hynë në PIP, por kërkohet të merret miratimi nga KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin për transfer të mjeteve e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarë (7 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021/ Lënda: 01Nr. 400/03-11124/21.

4. Propozim Vendimi për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të Komunës së Kaçanikut dhe NPK "Stacioni i Autobusëve" Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Ky Propozim Vendim ka rrjedhë si rezultat i pandemisë, me çka janë dëmtuar operatorët e transportit publik të udhëtarëve. Disa komuna kanë filluar me i subvencionuar operatorët publik, edhe kryetari i komunës e ka sjellë këtë propozim vendim në bazë të mundësive buxhetore që ka. Propozim vendimin e keni marrë, kjo çështje është debatuar edhe në KPF, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Unë kërkoj të shqyrtohen mundësitë për subvencionimin edhe të taksive, sepse edhe këta kategori janë transportues publik të udhëtarëve. Edhe veprimtaritë tjera të cilat janë prekur me tepër prej pandemisë, të shqyrtohen mundësitë e subvencionimit të tyre.

z. Bekim Koxha, Ka edhe kompani tjera të cilat janë dëmtuar si rezultat Covidit, si sallat e dasmave. Pyetja ime është: Sa është kostoja e subvencionimit ?

Kryesuesi i Kuvendit, Është e përcaktuar në Propozim Vendim kostoja. Për operatorët e transportit publik me autobus është 1.600€.

z. Besim Vishi, Kompanitë transportuese të udhëtarëve parimisht kompensohen me buxhetin e komunës, sepse e marrin një shumë të mjeteve buxhetore nga DAK.

z. Bekim Koxha, Ka edhe veprimtari të tjera të cilat nuk kanë punuar në kohë pandemie, si; restorantet, por nuk kemi buxhet ne si komunë me i kompensuar. Nëse secila nga veprimtaritë me bërë një kërkesë për subvencionim, mos po dalim pak si qesharak për subvencionimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Nuk kompensohen kompanitë, por kompensohen nxënësit që nuk kanë mundësi me paguar udhëtimin, ndërkaq kjo është ndihmë, për shkak të gjendjes që iu ka shkaktohet pandemia. Realisht kjo është dashur me u paraparë me ligjin për rimëkëmbje, besoj se do të parashihen, se janë dëmtuar kompanitë në kohë pandemie. Është mirë që komuna e jonë ka mundësi me i subvencionuar me një shumë simbolike. Ne nuk kemi buxhet me subvencionuar çdo veprimtari, disa komuna si Ferizaj, Prizreni i kanë subvencionuar kompanitë e transportit publik. Është mirë që edhe veprimtaritë tjera të cilat janë dëmtuar me u subvencionuar ashtu siç i parasheh ligji për rimëkëmbjen ekonomike, se ne si komunë nuk kemi mundësi me subvencionuar çdo veprimtari.

z. Besim Vishi, Me rëndësi është që këto mjete të ndara në emër të subvencionimit të kompanive transportuese, i marrin kompanitë transportuese.

z. Bekim Koxha, Unë edhe në mbledhjen e kaluar e kam potencuar; Më mirë është me i ndihmuar me një shumë simbolike, personat dhe familjarët të cilët janë prekur nga Covid-19, sesa veprimtaritë që nuk kanë funksionuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo mundet me qenë kërkesë për një mbledhje të radhës së KK, ndërkaq çështja sot është për veprimtaritë e caktuara. Për çështje tjera, mund të diskutojmë në mbledhje tjera të KK me pika të reja të rendit të ditës.

z. Bekim Koxha, Unë kam kërkuar një herë shqyrtimin e kësaj çështje, por nuk e keni shqyrtuar e as nuk me keni kthyer kurrfarë përgjigje.

z. Selim Reka, Unë edhe në mbledhjen e KPF e kam përkrahur këtë Propozim Vendim, ndërkaq kam kërkuar që të shqyrtohet mundësia që, sallat e dasmave të subvencionohen. Nuk kemi shumë salla të dasmave, ashtu që të gjendet një zgjidhje për subvencionimin e tyre me një shumë simbolike, e cila do të zbuste sadopak gjendjen e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, abstenim nuk ka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të Komunës së Kaçanikut dhe NPK "Stacioni i Autobusëve" Kaçanik / Lënda: 01Nr. 104/02-11203/21.

5. Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m², në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës "Ismail Raka" – segmenti nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri të "Xhamia e Dëshmorëve" në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Unë po ndërlidhem të arsyetimin, të gjerësia e rrugës 12 m, pasi që Bulevardi është 18 m, ne propozojmë që edhe kjo të kjo pjesë të bëhet 18m, e mos të bëhet ndarja diku 12 diku 18, por gjerësia nga Bulevardi deri të "Xhamia e Dëshmorëve" të jetë 18 m.

z. Ekrem Kyçyku, Unë mendoj së do të ishte qenë mirë paraprakisht me biseduar me pronarët preken me shpronësimin e pronave me këtë vendim.

z. Ukshin Qallaku, Ju e dini se rruga aktuale nuk i plotëson asnjë kriter, andaj ka qenë e paraparë edhe më herët me vazhduar rruga deri të, "Xhamia e Dëshmorëve". Ne kemi menduar gjerësia me qenë 12 m duke menduar se i plotëson kushtet, por edhe 18m është mendimi i juaj, nuk ka problem. Sa përket çështjes se bisedimeve me banorët, unë deri tani nuk e kam pasur asnjë vërejtje, kanë ardhur, kemi biseduar, janë njoftuar për shpronësimin për shkak të zgjerimit të rrugës dhe nuk kanë pasur ndonjë ankesë. Normal ata kanë në mendje sa ka me qenë çështja e kompensimit, por ajo është në kompetenca të ministrisë dhe ata për shpronësim i

marrin mostrat e duhura për mos me i dëmtuar pronarët. Ne, me atë rrugë e bëjmë edhe zgjerimin e zonës urbane të qytetit. Nëse mendoni së zgjerimi i rrugës duhet të jetë 18m, nuk ka asgjë të keqe. Aty janë dy rrugë, rruga aktuale dhe rruga të cilën po mendojmë me e hapur. Afërsia është shumë e madhe, hapësira e shfrytëzimit të pjesës tjetër mbetet shumë e ngushtë 18 + 6 është staza rreth Nerodimes, që ne kemi konsideruar se është e panevojshme. Mbetet ju me vendosur 12m apo 18 m me i shpronësuar të gjerësisë së rrugës. Ajo sipërfaqe që ka me u shpronësuar, ka me u paguar, sa të marrim kemi me paguar.

z. Ekrem Kyçyku, Konsideroj së për 18m duhet të pyeten pronarët, pa biseduar me ta, nuk bënë me vendosur KK.

z. Nexhat Loku, Në bazë të fotografimit nga gjeoportali e kemi parë së aty preken tre shtëpi me shpronësimin e sipërfaqes 12 m. Nëse ia merr 1m shtëpisë, atëherë duhet me ia shpronësuar krejt shtëpinë. Kërkesa jonë është, për në të ardhmen jo për tani, nëse mendohet me u zgjeruar e zhvilluar qyteti në atë pjesë, duhet të jetë sipërfaqja e zgjerimit e barabartë me atë të bulevardit.

z. Ekrem Kyçyku, Unë mendoj së kjo pikë duhet të shtyhet për mbledhjen vijuese, ashtu që me biseduar paraprakisht me pronarët e pronave se a janë për shpronësimin e 18 m gjerësi të rrugës apo jo. Nëse e merrni pëlqimin e pronarëve, atëherë në mbledhjen vijuese të KK mund të shqyrtohet kjo çështje.

z. Ukshin Qallaku, Të çështja e shpronësimit të gjerësisë së rrugës 12 m, e kemi pasur parasysh edhe atë pjesë ku preken 2 shtëpi. Ne, qoftë 12m apo 18m e shpronësimit, nëse mbetet një pjesë e dikujt e cila nuk mundet të shfrytëzohet, duhet me ia shpronësuar edhe atë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit, Tani dolën 2 propozime; 12 m apo 18 m të jetë shpronësimi i gjerësisë së rrugës.

z. Ekrem Kyçyku, Është biseduar me pronarët për 12 m, mirëpo për 18m nuk është biseduar me pronarët e pronave, kështu që duhet me marrë mendimin e tyre paraprakisht.

z. Selim Reka, Është mirë paraprakisht me biseduar me pronarët e pronave dhe nëse pranojmë, ne mund të mbajmë një mbledhje në fillim të muajit maj dhe me vendosur këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo çështje nuk është urgjente dhe ka procedura të mëtutjeshme që mund të zgjatë me vite. E shtyjme për mbledhjen vijuese, drejtori kontakton me pronarët se seriozisht është mirë që me shkuar 18m gjerësi ajo pjesë sa është bulevardi, e mos me u ngushtuar ajo pjesë. Propozimin me shtyrë këtë pikë, votuan njëzëri të gjithë njëzëri. **Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi që kjo pikë shtyhet për mbledhjen vijuese të KK.**

6. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, Parcelën kadastrale Nr. 01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, P.SH – Kullosë e klasës së 3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negocimit të ofertës;

Kryesuesi i Kuvendit, Me ndryshim plotësimin e ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të vitit 2019, është krijuar mundësia që edhe kryetarët e komunave të negociojnë oferta me investitorët. Pika 8 dhe 11 i këtij ligji i trajtojnë këto çështje. Besoj se kryetari i ka udhëhequr procedurat me investitorin, para se me sjellë çështjen në KK. Pjesë e mbledhjes janë

investitorët dhe pronari Agroni bashkë me bashkëpunëtorët e tij francezë. Me pëlqimin e juaj mund t'ua japim fjalën nëse kërkohet. E hapi diskutimin e kësaj pike; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë kjo çështje u shtrua në votim dhe e njëjta u miratua me shumicën e votave për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 anëtarë (7 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, Parcelën kadastrale Nr. 01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, P.SH – Kullosë e klasës së 3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negocimit të ofertës / Lënda: 01Nr. 104/02-11086/21.

7. Propozim Vendimi për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese/ Lënda: 01Nr. 941/01-11177/21.

8. Rishqyrtimi i Vendimit të KK 01Nr. 60/01-11084 i datës 18.03.2021 sipas kërkesës së MAPL, për harmonizimin e aktit me legjislacionin në fuqi;

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë çështje bëhet fjalë për vendimin për ndryshim plotësimit e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Mandati i komisionit është në mandatin e KK, ndërkaq koha është e limituar për shkak të zgjedhjeve lokale me zhvilluar procedura ky komision. Unë jam i mendimit që t'ia pushojmë mandatin këtij komisioni, pasi që procedurat e shpalljeve publike marrin kohë. Është mirë të pushohet mandati këtij komisioni, dhe KK i ri të formoj komisionin e ri vlerësues. Nëse ka kush diçka, hapi diskutimin për këtë pikë:

z. Ekrem Kyçyku, Ky komision nuk ka mandat me vazhduar me punën, pasi që komuna nuk ka të drejtë me dhënë në shfrytëzim prona komunale 6 muaj para zgjedhjeve lokale. Ne si LVV jemi të bindur se duhet pushuar mandatin këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim pushimin e funksionimit të komisionit vlerësues. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për pushimin e funksionimit të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale / Lënda: 01Nr. 60/01-11084/21.

9. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Besim Vishi, Në raport duhet të bëhet një përmirësim të numri i mbledhjeve, ku thuhet janë mbajtur 10 mbledhje, viti është shënuar 2019, ndërkaq duhet të jetë viti 2020.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Aprovimin e Raportit të punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-11409/21.

10. Raporti i punës i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2020; dhe

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë pikë, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Aprovimin e Raportit të punës i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-11271/21.

11. Arovimi i dorëheqjes së anëtares së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, Albana Fuga;

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Arovimin e Dorëheqjes së anëtares së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, Albana Fuga / Lënda: 01Nr. 60/01-4575/21.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 12:00. Deri fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e IV-të (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 29.04.2021

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,